



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1919/2 prot

Datë 16.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-07666-05-31-2024, me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjetllësit nga Impianti i Bovillës - Depo Maloku, Bashkia Kamëz*”, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz ShA.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, me NIPT (J91915001P) dhe adresë: Lagjja “Zall-Mner I Ri”, Rruga Nacionale Kamëz, 1054, Kamëz

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Kamëz ShA, me adresë: Rruga “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4323, datë 15.07.2024 dhe nr. Protokollit 1919/2024, datë 15.07.2024, të operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-07666-05-31-2024, me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjetllësit nga Impianti i Bovillës - Depo Maloku, Bashkia Kamëz*”, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz ShA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK kundërshton me anë të ankesës nr. A/2024/4323, datë 15.07.2024 dhe nr. Protokoli 1919/2024, datë 15.07.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

2. Operatori ekonomik ALMO Konstruksion sh.p.k skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshte shenuara :

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16
- Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

I. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributorprodhues për listën e mësipërme të mallrave.

2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme.

Kriteri 2.3.5 kapaciteti teknik I kritereve te veçanta per kualifikim per mallin Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400 nuk plotesohet nga operatori ekonomik ALMO Konstruksion shpk per arsyet e poshteshenuara:

I. Mungon autorizimi/marrëveshja qe tregon lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit.

II. Mungon katalogu/fragmente te katalogut qe te tregojë dhe te specifikojë mallin e mesiperm.

III. Çertifikata ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit është ne gjuhe te huaj. (Referuar kritereve per kualifikim të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.)

Shenim: Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 16.07.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri